



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 28 regjistër (JR)  
Datë 05.11.2018

Nr. 8 i vendimit  
Datë 16.04.2019

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Relatore</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>

– mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, më datë 16.04.2019, ora 10:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Hans Peter Kijlstra, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket ankimit:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Arben Nela, Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 44, datë 23.07.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**BAZË LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet A-F të Aneksit të Kushtetutës, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nenet 62, 63 e vijues të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, Kodi i Procedurës Civile.

## **Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,**

pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Natasha Mulaj, analizoi shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, si dhe pasi e bisedoi atë,

### **VËREN:**

#### **I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin nr. 44, datë 23.07.2018, ka vendosur *shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Arben Nela, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*
2. Komisioni arriti në këtë përfundim pasi administroi të tria raportet e vlerësimit, të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ( në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31-33 të ligjit nr. 84/2016, nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34-39 të ligjit nr. 84/2016 dhe nga Grupi i Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme (në vijim GPPP), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, por duke e përfunduar procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Arben Nela vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë e duke mos vendosur mbi kriterin e kontrollit të figurës dhe atë të vlerësimit të aftësive profesionale.
3. Komisioni, pasi shqyrtoi deklaratimet periodike të subjektit të rivlerësimit, si dhe deklaratimet në deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit kalimtar (*vetting* 2017), provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të postës elektronike, provat shkresore të administruara nga Komisioni në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim që të kuptohet më qartë raporti midis aseteve të deklaruara dhe të ardhurave të ligjshme, si dhe analizën ligjore të veçantë për çdo pasuri, arriti në përfundimin se:
  - i. Për pasurinë apartament me sipërfaqe 99,4 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, regjistruar në regjistrin hipotekor nr. {\*\*\*}, datë 25.04.2011, në pronësi të shtetasit Arben Nela dhe B.N., *subjekti i rivlerësimit ka ndër marrë hapa për të fshehur ose evidentuar në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim të tij, në përputhje me nenin D, paragrafi 5 i Aneksit të Kushtetutës dhe ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kriterin e pasurisë sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.*
  - ii. Për pasurinë banesë me sipërfaqe 136,9 m<sup>2</sup>, ndodhur në Lanabregas, Tiranë, regjistruar në ZRPP Tiranë, më datë 10.04.2015, me nr. pasurie {\*\*\*}, në zonën kadastrale {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, f. {\*\*\*}, në pronësi të shtetasit Arben Nela, *subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për vlerësimin e pasurisë, në bazë të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, nuk ka shpjeguar në mënyrë të besueshme origjinën e ligjshme të këtij aseti, sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të*

*Kushtetutës, si dhe ka ndërmarrë hapa për të fshehur ose evidentuar në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim të tij, në përputhje me nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës. Gjithashtu, personat e tjerë të lidhur, babai dhe vëllezërit, nuk arritën të justifikojnë ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie, sipas parashikimeve të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.*

iii. Për pasurinë apartament me sipërfaqe 67,6 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, në pronësi të shtetasës B.N., subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar në mënyrë të besueshme origjinën e ligjshme të këtij asemi, sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, ka fshehur dhe evidentuar në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim të tij, në përputhje me nenin D, paragrafi 5 i Aneksit të Kushtetutës, si dhe ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për vlerësimin e pasurisë sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

4. Në përfundim të procesit të rivlerësimit vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, Komisioni arriti në përfundimin që subjektit të rivlerësimit Arben Nela, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, t’i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

## **II. Shkaqet e ankimit**

Kundër vendimit nr. 44, datë 23.07.2018, të Komisionit është ushtruar ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (në vijim Kolegji) nga subjekti i rivlerësimit Arben Nela, i cili kërkon ndryshimin e këtij vendimi dhe konfirmimin në detyrë të tij, duke parashtruar shkaqet e mëposhtme.

### **II/1. Shkaqet procedurale**

5. Ndaj subjektit të rivlerësimit Arben Nela është zhvilluar një proces i parregullt ligjor në kuptim të nenit 42 e 179/b, pika 2 e Kushtetutës, nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim: KEDNj), si dhe nenit 4, pikat 5 dhe 6, dhe nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.
6. Komisioni, në kundërshtim me nenin 45, pika 1 e Kodit të Procedurave Administrative, nuk e ka njohur subjektin me materialet e dosjes, konkretisht me analizën financiare të kryer nga Komisioni, si një nga provat më të rëndësishme, për sa i përket vlerësimit të kriterit të pasurisë. Vetëm një ditë përpara seancës dëgjimore, i është vënë në dispozicion subjektit metodologjia e përdorur, e cila është një rregullore e përgjithshme.
7. Me kërkesën e datës 26.06.2018, subjekti ka kërkuar marrjen e disa provave, pyetjen e dëshmitarëve, por Komisioni nuk ka kthyer përgjigje për sa më sipër, duke refuzuar paraprakisht provat e kërkuara dhe vetëm në vendimin objekt ankimi ka arsyetuar se kjo kërkesë është e pabazuar në ligjin nr. 84/2016, nenin 49, pika 8 dhe më tej 6 e po të njëjtit nen, pasi fakti që u kërkuar të provohej nga ana e subjektit të rivlerësimit me dëshmitarë, ishte provuar gjatë gjykimit. Komisioni ka vepruar në kundërshtim me nenin Ç, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, nenin 49, pika 9 e ligjit nr. 84/2016, pasi refuzimi i kërkesës për marrjen e provës bëhet me vendim të arsyetuar të Komisionit ose të Kolegjit të Apelit, duke argumentuar shkaqet e refuzimit, gjë e cila nuk u

realizuar në përputhje me këtë dispozitë nga Komisioni dhe me rregulloren e miratuar nga Komisioni, sipas të cilave brenda 5 ditëve nga paraqitja e kërkesës, trupi gjykues vendos me arsyetim për pranimin ose refuzimin e kërkesës për marrjen e provave. Për sa më sipër, në kundërshtim me kriteret ligjore të parashikuara në nenet 49 e vijues të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka dhënë një vendim të padrejtë, të pabazuar, të njëanshëm dhe në kundërshtim me provat dhe faktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit.

8. Nuk është respektuar procedura e vlerësimit të provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, sipas kërkesave të nenit 48 të Kodit të Procedurave Administrative, duke e kthyer seancën e datës 23 korrik 2018 në një seancë tërësisht formale.
9. Komisioni nuk ka njoftuar subjektin e rivlerësimit në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Kodit të Procedurave Administrative për rezultatet përfundimtare të hetimit. Gjithashtu, Komisioni ka ftuar subjektin në seancë dëgjimore në kundërshtim me nenin 179/b, pika 2 e Kushtetutës, nenet 45, 55 të ligjit nr. 84/2016, nenet 48, 59, 87, pika 2 germa “ç” e Kodit të Procedurave Administrative. Sipas subjektit, ai është thirrur më datë 12.07.2018 dhe seanca është caktuar më datë 18.07.2018.
10. Sipas subjektit, me paraqitjen e provave dhe shpjegimeve të kërkuara nga Komisioni, ezaurohet edhe barra e provës që parashikon ligji. Në këtë rast, barra e provës i takon Komisionit për të marrë prova të reja, të cilat do të rrëzonin pretendimet e subjektit.
11. Mënyra e proceduar nga Komisioni nuk respekton nenin Ç, pika 5, nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 183 të Kodit të Procedurës Civile dhe, bashkë me ta, edhe nenet 41 dhe 179/b, pika 2 e Kushtetutës, si dhe nenin 6 të KEDNj-së, lidhur me parimin e realizimit të një mbrojtjeje efektive. Paraqitja nga Komisioni vetëm në arsyetimin e vendimit se asnjë nga provat e tij nuk janë marrë parasysht, përbën mohim të së drejtës së subjektit për të paraqitur kundërgjegje dhe për të kundërshtuar gjetjet e hetimit paraprak të Komisionit, gjë e cila medoemos duhet t'i nënshtrohet debatit në seancë dëgjimore. Gjithashtu, në kundërshtim me pikat 10 dhe 11 të aktit “Hapat proceduralë”, Komisioni nuk i ka dërguar subjektit të rivlerësimit relacionin përfundimtar para seancës dëgjimore.
12. Shkeljet e procesit të rregullt ligjor kanë vazhduar edhe gjatë seancës dëgjimore të datës 23.07.2018, gjatë së cilës subjekti i është kufizuar e drejta për t'u dëgjuar, duke pasur ndërhyrje nga kryesuesja e seancës në mënyrë të vazhdueshme deri në ndërprerjen e fjalës.
13. Subjekti pretendon gjithashtu se është gjykuar nga një gjykatë e njëanshme dhe paragjyqese, pasi edhe marrja, administrimi, pra hetimi kryesisht në lidhje me pasurinë, çmuarja e provave dhe më pas dhënia e vendimit për subjektin po nga i njëjti trup gjykues i Komisionit cenon haptazi parimin e gjykimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.
14. Komisioni, pas administrimit të tri raporteve të rivlerësimit, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, duke u bazuar vetëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke mos vendosur mbi kriterin e kontrollit të figurës dhe atë të vlerësimit të aftësive profesionale, çka e bën subjektin të mendojë se trupi gjykues ka vepruar me paragjykim,

gjë që ka ndikuar në humbjen e ekuilibrit përgjatë procesit të vlerësimit të subjektit.

15. Nga Komisioni është shkëlur edhe parimi i prezumimit të pafajësisë në kuptim të nenit 30 të Kushtetutës, si dhe nenit 6.2 të KEDNj-së. Sipas shortit të organizuar nga ILDKPKI-ja, subjekti i rivlerësimit është shortuar si pjesë e listës me 166 zyrtarë, të cilët i janë nënshtruar kontrollit të plotë të pasurisë nga viti 2003 deri në vitin 2009. Në fund të këtij kontrolli, është informuar se deklaratimet e tij kanë qenë të sakta dhe pasuria e deklaruar mbulohet mjaftueshëm nga burimet e deklaruar. Fakti që ILDKPKI-ja nuk ka marrë asnjë masë ndër vite ndaj subjektit të rivlerësimit, provon se raporti i sjellë nga ky i fundit pasqyron konkluzione të pavërteta.
16. Subjekti i rivlerësimit është shkarkuar në kundërshtim me nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, pasi duhet të ekzistojë bashkëzistenca e papërshtatshmërisë në lidhje me kriterin e figurës dhe atë të pasurisë në kuptim të këtij ligji.
17. Mospasqyrimi i likuiditeteve nuk passjell pamjaftueshmëri të burimit të ligjshëm për krijimin e pasurisë dhe, nëse në këtë rast ka pasaktësi të konstatuara, ato duhet të mbahen parasysht se nuk janë të qëllimshme dhe nuk mund të konsiderohen si deklarim i rremë apo fshehje e pasurisë.
18. Komisioni nuk ka mbajtur të njëjtin standard objektiv vlerësimi në raport me besueshmërinë, pasi në vendimin nr. 51, datë 25.07.2018, vlerëson si të paqëllimtë mungesën e deklaratimit të pasurisë në deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017, ndërsa për subjektin e rivlerësimit nuk zbaton të njëjtin standard.
19. Subjekti pretendon se nga ana e tij dhe e bashkëshortes së tij nuk ka pasaktësi dhe deklaratimet e tij janë te plota, nuk ka fshehje të pasurisë, nuk ka kryer deklarim të rremë, deklaratimet janë të vërteta, të sakta e në përputhje me ligjin, gjithashtu vlera e këtyre pasurive justifikohet ligjërisht me të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, në përputhje me paragrafin e parë të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Pasaktësitë në deklarim nuk mund të konsiderohen si deklarim i rremë, fshehje apo mungesë burimesh të ligjshme, pasi mungon dashja; pra janë pasaktësi të bëra pa qëllim.

## **II/2. Shkaqet e ankimit për kriterin e pasurisë**

20. *Për pasurinë apartament me sipërfaqe 99,4 m<sup>2</sup>, të ndodhur në rrugën "{\*\*\*}", Tiranë, subjekti ka parashtruar shkaqet e mëposhtme.*
  - i. Komisioni ka gabuar kur arsyeton se pagesa e apartamentit është bërë përmes Bankës Credins, kjo pasi pagesat për apartamentin janë bërë *cash* në arkën e shoqërisë "{\*\*\*}" ShPK, përmes mandatpagesës nr. 1, datë 19.01.2004, në shumën 8335 euro; mandatpagesës nr. 2, datë 20.12.2005, në shumën 8.000 euro; mandatpagesës nr. 3, datë 18.09.2006, në shumën 25.000 euro, gjë që vërtetohet përmes shkresës së shoqërisë "{\*\*\*}" ShPK me nr. 29, datë 07.06.2018, dhe deklaratave noteriale të shtetasve X.I. dhe I.K. si ish-ortakë të shoqërisë "{\*\*\*}" ShPK, si dhe shtetasit A.K, në cilësinë e përfaqësuesit të zyrës së shitjeve të shoqërisë "{\*\*\*}" ShPK.

- ii. Kursimet dhe gjendja *cash* nuk janë pasqyruar në deklaratat periodike të pasurisë të viteve 2003, 2004 dhe 2005, për shkak se nuk është treguar kujdesi i duhur në plotësimin e deklaratave. Mospasqyrimi i kursimeve në deklaratën e pasurisë nuk sjell paligjshmëri të burimit të krijimit të pasurisë. Pasaktësitë në plotësimin e deklaratave nuk mund të konsiderohen si deklarim i rremë, fshehje apo mungesë burimesh të ligjshme.
- iii. Analiza financiare e viteve 2004 dhe 2005 e Komisionit, që llogarit në mënyrë të pakuptimtë si pjesë të të ardhurave shumë 10.000 euro, është e gabuar, pasi kjo shumë nuk është përdorur asnjëherë dhe kjo rezulton e provuar edhe nga hetimi.
- iv. Referuar ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 (ligji i kohës), nuk ka pasur asnjë dispozitë ligjore që të parashikonte se pasqyrimi i likuiditeteve (gjendje *cash*) në atë kohë përbënte shkelje administrative, paligjshmëri të të ardhurave apo fshehje. Madje nenin 25 i ligjit nr. 9049, i ILDKP-së, datë 10.04.2003, parashikonte si parregullsi edhe mosjustifikimin për shumat 1.000.000 lekë dhe 2.000.000 lekë për deklarimet periodike dhe fillestare përkatësisht.
- v. Komisioni ka gabuar kur ka arritur në përfundimin se nuk është deklaruar në deklaratën e pasurisë së vitit 2004 pasuria apartament e porositur sipas kontratës së shitjes paraprake të datës 19.01.2004, as edhe pagesat e bëra në vitet 2004 dhe 2005. Ky deklarim nuk është bërë, sepse sendi në atë kohë nuk ishte formësuar ende. Bazuar në nenet 144, 149, 163, 164, 192 dhe 193 të Kodit Civil, si dhe në vendimin nr. 1, datë 06.01.2009, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk kanë pasur detyrim deklarimi në vitin 2004 dhe 2005, sepse sendi ende nuk ekzistonte dhe subjekti nuk kishte posedim faktik mbi apartamentin, për rrjedhojë nuk ka pasur asnjë të drejtë reale.
- vi. Komisioni ka administruar gjatë hetimit administrativ provat shkresore të paraqitura nga subjekti, konkretisht deklaratat noteriale të shtetasve I.K., Xh.I., A.K. etj., datë 08.06.2018, por nuk rezulton t'i ketë analizuar dhe as nuk ka arsyetuar në vendim përfundimtar faktet që ato përmbajnë, kjo në kundërshtim me nenin 49, pika 1, germa "b" e ligjit nr. 84/2016.
- vii. Komisioni ka gabuar kur ka arritur në përfundimin se nuk është e qartë pse subjekti i rivlerësimit ka marrë hua me kontratën {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 16.08.2006, nga P.H., pra 9 muaj pasi kishte paguar vlerën e plotë të apartamentit, më 23.11.2005. Pagesa e fundit për apartamentin është bërë më datë 15.09.2006, pra 1 muaj pasi është marrë huaja, pra në funksion të plotë të kryerjes së pagesës për apartamentin, siç edhe është deklaruar në deklaratën e pasurisë së vitit 2006.
- viii. Lidhur me kthimin e huas prej 25.000 eurosh, është bërë me këste. Fillimisht, janë paguar 10.000 euro më datë 31.12.2006. Në vijim, për të shlyer huan, subjekti ka marrë një kredi më datë 27.12.2007 në Raiffeisen Bank, në vlerën 1.000.000 lekë, dhe së bashku me kursimet e viteve 2006 dhe 2007, në total 15.000 euro, më datë 30.12.2007, i ka dorëzuar *cash* te shtetasi R.H., sipas porosisë së shtetasës P.H.. Kjo e fundit ka konfirmuar marrjen më datë 04.08.2008. Më pas, është shlyer me kursimet nga paga edhe shuma 5.000 euro *cash*, më datë 21.08.2008.

ix. Pavarësisht se deklarata për kthimin e huas e shtetases P.H. është e panoterizuar, kjo justifikohet me faktin se është një marrëdhënie e posaçme në kuptim të nenit 233, germa “c” e Kodit të Procedurës Civile, ndërkohë që Kodi Civil nuk parashikon asnjë formë të caktuar për të provuar ekzistencën e saj, ndërkohë që veprimi juridik me shkresë është i njohur nga neni 81, kur nënshkruhet nga ai që e kryen, siç është edhe rasti i shtetases P.H.

21. *Për pasurinë banesë 136,9 m<sup>2</sup>, ndodhur në Lanabregas, Tiranë*, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar shkaqet e ankimit të mëposhtme.

i. Komisioni ka gabuar kur arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet pasaktësive, duke e paraqitur si pasuri në posedim, ka fshehur në deklaratën (*vetting*) 2017 truallin prej 300 m<sup>2</sup>, mbi të cilin është ndërtuar banesa.

ii. Komisioni ka gabuar, pasi në kundërshtim me shkresën e ZVRPP Tiranë nr. {\*\*\*}, datë 14.06.2018, ka arritur në përfundimin që subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën (*vetting*) 2017 pronësinë mbi truallin 300 m<sup>2</sup> në Lanabregas. Faktet e përmendura në shkresën si më sipër të ZVRPP Tiranë, janë në përputhje të plotë edhe me shkresën tjetër të ZVRPP Tiranë me nr. {\*\*\*}, datë 31.01.2018, sipas së cilës rezulton se Arben Nela ka në pronësi vetëm apartamentin 121,6 m<sup>2</sup> dhe jo truallin.

iii. Mosdeklarimi në mënyrë specifike i truallit 300 m<sup>2</sup>, përbën pasaktësi por jo fshehje, dhe si i tillë nuk mund të jetë shkak për shkarkim nga detyra, në përputhje edhe me qëndrimin e mbajtur në vendimin nr. 4, datë 26.07.2018, të Kolegjit. Për këtë arsye, është cenuar parimi i proporcionalitetit në dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit Arben Nela.

iv. Subjekti i rivlerësimit Arben Nela është dekretuar prokuror me dekretin nr. {\*\*\*}, datë 05.06.2002, ndërsa kjo pasuri është ndërtuar në vitin 1999-2001 nga prindërit e subjektit, me kursimet e tyre.

v. Komisioni ka gabuar kur ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar aplikimin për legalizim në vitet 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009, me qëllim që të mos deklaronte burimin e krijimit të kësaj pasurie dhe ka vazhduar shtesën e katit të dytë dhe të tretë të banesës në vitet 2011-2013.

vi. Nuk është marrë në konsideratë nga Komisioni, shkresa e Institutit të Sigurimeve Shoqërore (në vijim ISSh) e datës 12.06.2018 për të ardhurat neto të babait për vitet 1994-2001. Babai i subjektit të rivlerësimit, nga viti 1994 deri në vitin 2001, ka pasur të ardhura të mjaftueshme nga paga e tij si mësues, në vlerën 1.167.107 lekë, për të ndërtuar objektin. Gjithashtu, nuk janë llogaritur të ardhurat nga viti 1967-1993, ku për këto vite, në ISSh Tiranë nuk gjenden listëpagesat.

vii. Nëna e subjektit të rivlerësimit gjatë viteve 1992 deri në vitin 1998 ka përfutuar të ardhura nga ferma e saj. Është një fakt i njohur botërisht që fermat në ato vite kanë qenë të paformalizuara dhe kjo nuk ka nevojë të provohet. Për periudhën 1999-2001 të ardhurat e nënës kanë qenë 1.260.000 lekë. Për periudhën kur ka qenë e punësuar pranë subjektit M.H. me NIPT {\*\*\*}, me

pagë 35.000 lekë/muaj, ajo nuk ka pasur dijeni se punëdhënësi i saj nuk ka paguar tatimin mbi të ardhurat dhe sigurimet shoqërore. Detyrimi për pagimin e tatimit mbi të ardhurat personale dhe për sigurimet shoqërore është i punëdhënësit, sipas nenit 117/1 të Kodit të Punës.

viii. Nëna dhe vëllezërit e ankuesit nuk kanë qenë ndonjëherë subjekt i deklaramit të pasurisë, për këtë arsye parashikimi Kushtetues i nenit D, pika 3, fjalia e dytë e Aneksit të Kushtetutës, nuk gjen zbatim në këtë rast.

ix. Komisioni ka gabuar kur ka arritur në përfundimin se vlera e shpenzuar për ndërtimin e katit të parë për një sipërfaqe prej 136,9 m<sup>2</sup> është rreth 3.400.000 lekë, sipas kostos mesatare të ndërtimit të Entit Kombëtar të Banesave (në vijim EKB) dhe formularit të vetëdeklarimit pranë ALUIZNI-t, ku viti i ndërtimit ishte viti 2001, pasi sipas aktekspertizës tekniko-ekonomike nga eksperte V.G., vlera totale e ndërtimit është 508.584 lekë.

x. Komisioni ka konstatuar në mënyrë të gabuar se vëllezërit e subjektit të rivlerësimit duhen konsideruar si “persona të tjerë të lidhur”, pasi bazuar në nenin 3, pikat 13 dhe 14, nenin 30, nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, në nenin 3, pika 11, nenin 4, nenin 5 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, si dhe në nenin 1, pika 8 e ligjit nr. 85/2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, të ndryshuar, S.N. dhe R.N. nuk janë persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit Arben Nela.

xi. Nëse vëllezërit konsiderohen “persona të tjerë të lidhur”, ata gjithsesi kanë pasur të ardhura të mjaftueshme nga puna e tyre, ndërkohë që sa i takon ligjshmërisë së të ardhurave të tyre, kompanitë ku ata kanë punuar, kanë pasur detyrimin të paguajnë tatimet dhe sigurimet shoqërore në zbatim të nenit 117/1 të Kodit të Punës.

xii. Është i gabuar qëndrimi i Komisionit kur arsyeton se, për shkak të aplikimit në të njëjtin formular kërkesë për legalizim nga Arben Nela dhe vëllezërit, këta të fundit konsiderohen persona të tjerë të lidhur. E njëjta anëtare e trupit gjykues, Valbona Sanxhaktari, në vendimin e Komisionit nr. 42, datë 18.07.2018, në dallim me qëndrimin e Komisionit të mbajtur në vendimin objekt ankimi, nuk i konsideron si persona të tjerë të lidhur, personat që kanë aplikuar në të njëjtin formular kërkesë për legalizim.

22. *Për pasurinë apartament me sipërfaqe 67,6 m<sup>2</sup>, i ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar shkaqet e ankimit të më mëposhtme.*

i. Komisioni ka gabuar kur ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme për blerjen e këtij apartamenti, duke pasur parasysh kohën e shlyerjes së pagesës 12.500 euro, në momentin e firmosjes së kontratës së zëvendësimit të kreditorit.

ii. Huaja prej 40.000 eurosh, marrë nga shtetasja P.H. përmes kontratës së huas me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 21.08.2012, është reale, jo deklarative.



iii. Lidhur me vlerën provuese të deklaratave noteriale të datës 14.09.2012 dhe 03.05.2013, bazuar në nenin 253 dhe 257/1 të Kodit të Procedurës Civile, ato përbëjnë provë të plotë dhe nuk mund të merren me rezervë.

iv. Komisioni ka gabuar kur ka konstatuar se ka mungesë dokumentacioni provues ligjor për të vërtetuar të ardhurat e siguruar nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, të përfituara nga licenca profesionale nr. {\*\*\*}, datë 05.05.2004, në emër të B.N., pasi personi i lidhur B.N. ka pasur një kontratë pune me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, më datë 01.03.2006, kontratë e cila ka zgjatur deri në vitin 2012 dhe për shërbimin e ofruar, ka përfitur të ardhurat e deklaruara në vite, në vlerën 3718.500 lekë.

### III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

23. Subjekti i rivlerësimit Arben Nela, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit dhe, si kandidat për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në bazë të 279 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *me përparësi*.
24. Subjekti i rivlerësimit Arben Nela është bërë subjekt deklarues në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI) në vitin 2003, me numër indeksi {\*\*\*} dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.04.2005, ka plotësuar/dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave privatë periodikë/vjetorë të tij.
25. ILDKPKI-ja, në përfundim të procedurës së plotë të kontrollit të pasurisë, ka përgatitur raportin përfundimtar të paraqitur në Komision dhe, bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit Arben Nela:
- nuk ka bërë deklaram të saktë në përputhje me ligjin;
  - nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
  - ka kryer fshehje të pasurisë;
  - ka kryer deklaram të rremë;
  - nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
26. Gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, së bashku me ankimin, subjekti i rivlerësimit kërkoi marrjen në cilësinë e provës të disa akteve shkresore që janë:
- i. shkresë e Bankës Credins nr. {\*\*\*}, datë 19.10.2018;
  - ii. procesverbal nr. {\*\*\*}, datë 19.11.2012, dhe vendim i INU Dajt nr. {\*\*\*}, datë 20.11.2012;
  - iii. procesverbal nr. {\*\*\*}, datë 19.11.2012, dhe vendim i INU Dajt nr. {\*\*\*}, datë 20.11.2012;
  - iv. shkresë e OShEE-së nr. {\*\*\*} prot., datë 18.10.2018;
  - v. faturat e energjisë elektrike në emër të shtetasës M.Xh. për periudhën shtator 2011 - maj 2013 nga OShEE, të noterizuara me vërtetim njësie me origjinalin, me nr. {\*\*\*} rep., datë 22.10.2018;

- vi. faturat e UKT-së në emër të shtetasës M.Xh. për periudhën shkurt 2011 - prill 2013, të noterizuara me vërtetim njësie me origjinalin, me nr. {\*\*\*} rep., datë 22.10.2018.
27. Trupi gjykues bazuar në nenin 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, me vendim të ndërmjetëm vendosi të mos i pranojë këto akte, pasi i konsideroi ato si të panevojshme për shqyrtimin e çështjes.
28. Në datën 26.03.2019, pranë Kolegjit është depozituar kërkesa e subjektit të rivlerësimit, për të administruar shpjegimet dhe provat e dërguara Komisionit, më datë 09.07.2018. Ndërkohë që subjekti ushtroi të drejtën e tij për t’u njohur me dosjen në Kolegji, pastaj me kërkesën e tij u administruan dhe u morën në shqyrtim edhe këto akte shkresore:
- i. *e-mail* i datës 09.07.2018, dërguar Komisionit;
  - ii. shkresa nr. {\*\*\*}, datë 05.07.2018, e ILDKPKI-së;
  - iii. njoftimi zyrtar për hedhjen e shortit nga ana e ILDKPKI-së, i datës 29.04.2009;
  - iv. listën me 166 zyrtarë të shortuar nga ILDKPKI-ja, më datë 29.04.2009, ku rezultojnë subjektin Arben Nela.
29. Në datën 08.04.2019, pranë Kolegjit u depozitua kërkesa e subjektit të rivlerësimit, për të administruar si provë, aktet si më poshtë:
- i. shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 19.09.2018, e DSIK-së, dërguar z. Arben Nela;
  - ii. Raport i DSIK-së, me nr. {\*\*\*} prot., datë 27.10.2017, dërguar KPK-së;
  - iii. dekret nr. {\*\*\*}, datë 05.06.2002, i Presidentit të Republikës për emërimin si prokuror të z. Arben Nela.

Lidhur me sa sipër, trupi gjykues vlerëson se ato nuk mund të merren në cilësinë e provës, pasi për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, Komisioni nuk ka konkluduar me vendim. Në këtë kuptim, këto akte nuk mund të jenë objekt shqyrtimi në Kolegji. Bazuar në nenin 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Kolegjit çmon se marrja e tyre është e panevojshme.

30. Në datën 10.04.2019, pranë Kolegjit u depozitua kërkesa e subjektit të rivlerësimit, për të administruar si provë, aktet si më poshtë:
- i. *statement* (nxjerrje llogarie) i Tirana Bank, në emër të shtetasës B.N.;
  - ii. kopje e pasaportave të shtetasve B.Gj., A.I.;
  - iii. të dhëna për hyrje-daljet e fëmijëve: A.H., K.H. dhe N.H.;
  - iv. vërtetim nr. {\*\*\*}, datë 13.03.2019, i Repartit Ushtarak nr. {\*\*\*};
  - v. deklaratë noteriale e shtetasit A.T..

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se aktet e kërkuara për t’u marrë në cilësinë e provës nga subjekti i rivlerësimit, nuk mund të pranohen si të tilla, pasi bazuar në nenin 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, në këtë fazë të procesit, palët mund të paraqesin vetëm parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim, por jo fakte dhe prova të reja. Në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë që pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto prova gjatë shqyrtimit të çështjes në Komision. Gjithashtu, trupi gjykues i Kolegjit çmon si të panevojshme marrjen e këtyre akteve në cilësinë e provës, duke qenë se situata faktike është e qartë në kuptim të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012.

31. Sa i takon kërkesës së subjektit të rivlerësimit për vënien në dispozicion të një kopjeje të relacionit financiar të përgatitur nga këshilltari ekonomik, trupi gjykues vlerëson se relacioni është një akt këshillimor i trupës.
32. Për gjithë sa më sipër, bazuar në nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi të vazhdojë gjykimin e çështjes në dhomë këshillimi.

### III/1. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit për kriterin e pasurisë

33. Nisur nga aktet shkresore që janë administruar në dosje, si dhe shkaqet në ankim të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit, për sa i përket kriterit të vlerësimit të pasurisë, bazuar në nenin "D", pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 30 e vijues të ligjit nr. 84/2016, kryen kontrollin e vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, personin e lidhur dhe personat e tjerë të lidhur, në përputhje me kriteret që parashikojnë dispozitat e mësipërme.
34. **Për pasurinë 1:** *apartament me sipërfaqe 99,4 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën "{\*\*\*}", Tiranë, regjistruar në regjistrin hipotekor me nr. {\*\*\*}, datë 25.04.2011, në pronësi të shtetasit Arben Nela dhe shtetases B.N., blerë në shumën 41.251 euro nga shoqëria "{\*\*\*}" ShPK, sipas kontratës së shitjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 19.03.2011, në vijim të kontratës paraprake të shitjes, datë 19.01.2004.*
35. Nga shqyrtimi i provave të administruara në dosjen gjyqësore, rezulton se në emër të subjektit të rivlerësimit Arben Nela dhe bashkëshortes së tij, B.N. (Gj.), figuron i regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (në vijim ZVRPP), Tiranë, apartamenti me sipërfaqe 99,4 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën "{\*\*\*}", me pjesë takuese 50% secili.
36. Nga subjekti i rivlerësimit Arben Nela, ky apartament është deklaruar për herë të parë në deklaratën e pasurisë të vitit 2006, i blerë nga shoqëria "{\*\*\*}" ShPK, i paregjistruar në regjistrat publikë (ZRPP), krijuar si pasuri në vitin 2006 me anë të kontratës së shitjes paraprake të datës 15.09.2006, me vlerë 41.251 euro dhe pjesë takuese 100%. Në vitin 2011 subjekti i rivlerësimit Arben Nela ka deklaruar regjistrimin e këtij apartamenti në regjistrin hipotekor nr. {\*\*\*}, datë 25.04.2011, në emër të tij dhe bashkëshortes, B.N.. Në deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017, subjekti i rivlerësimit Arben Nela deklaroi se apartamenti është blerë përmes kontratës së shitjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 19.03.2011, në vijim të kontratës paraprake të shitjes datë 19.01.2004, me pjesë takuese 50%.
37. Referuar në deklaratimet sa më sipër, rezulton të ketë mospërputhje midis deklaratimit të vitit 2006 dhe deklaratës së pasurisë (*vetting*) 2017, pasi subjekti i rivlerësimit deklaroi ta ketë krijuar pasurinë në vitin 2006 përmes kontratës së shitjes paraprake të datës 15.09.2006, e së fundmi në deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017, deklaroi se kontrata e shitjes paraprake është bërë më datë 19.01.2004, ndërkohë që pranë Komisionit dhe në ankim subjekti i rivlerësimit pretendon se deklarimi i bërë në vitin 2006, që kontrata e shitjes paraprake është e datës 15.09.2006, është një lapsus i tij. Trupi gjykues vlerëson se ky deklarim nuk mund të jetë lapsus, pasi nga subjekti i rivlerësimit, viti 2006, si vit i nënshkrimit të kontratës, tregohet dy herë brenda së njëjtës deklaratë, një herë si moment i krijimit të pasurisë dhe një herë si kohë e lidhjes së kontratës paraprake të shitjes.

38. Trupi gjykues, referuar akteve të administruara në dosje, ka arritur në përfundimin se mënyra e likuidimit të këtij apartamenti është pagesa e kryer pranë Bankës Credins. Ky apartament është likuiduar pranë kësaj banke sipas mandatpagesave të datës 23.12.2004, në vlerën 22.000 euro; të datës 08.09.2005, në vlerën 10.000 euro; të datës 08.11.2005, në vlerën 5.000 euro; dhe të datës 23.11.2005, në vlerën 4.251 euro. Ky fakt bazohet në shkresën nr. {\*\*\*}, datë 12.06.2018, të Bankës Credins dhe në shkresën nr. {\*\*\*}, datë 07.03.2018, të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK.
39. Lidhur me pretendimin e subjektit në ankim, që ky likuidim i apartamentit është kryer *cash* në zyrat e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, sipas mandatpagesave me nr. {\*\*\*}, të datës 19.01.2004, në vlerën 8.335 euro, nr. {\*\*\*}, datë 20.12.2005, në vlerën 8.000 euro dhe nr. {\*\*\*}, datë 18.09.2006, në vlerën 25.000, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim i subjektit nuk qëndron pasi:
- i. Referuar nenit 9 të ligjit nr. 7661, datë 19.01.1993, “Për kontabilitetin”, i cili parashikon ndër të tjera se *çdo dokument kontabël mbështetet në një dokument justifikues (fillestar)<sup>1</sup>, dhe “kërkesat e formës dhe të vlefshmërisë të dokumenteve justifikuese për t’u pranuar për regjistrime në kontabilitet, përcaktohen me regjimet kontabël<sup>2</sup>. Referuar “Sistemit kontabël të përgjithshëm<sup>3</sup>, pika 2.2, “Rregullat e përgatitjes së dokumenteve justifikuese”, dokumenti justifikues bazë përgatitet në kohën kur kryhet veprimi dhe çdo dokument duhet të përmbajë:*
    - a) emërtimin e dokumentit, numrin rendor (ose serial) si dhe datën;
    - b) emërtimin e ndërmarrjes dhe të njësisë organizative brenda saj, që lëshon dokumentin, formën juridike dhe adresën e ndërmarrjes;
    - c) tregimin e personit ose të njësisë administrative që urdhëron kryerjen e veprimit, të personit që ekzekuton veprimin, si dhe, në varësi të organizimit të lëvizjeve të vlerave e të veprimeve financiare, tregimin dhe firmën e personit që merr në ngarkim vlerat materiale apo monetare (faqe 12 e Planit Kontabël të Përgjithshëm);
    - ç) përshkrimin e përmbajtjes së objektit të veprimit apo të ngjarjes tjetër dhe, në varësi të natyrës së këtyre të fundit, treguesit sasiorë dhe vlerorë;
    - d) veprimet për shitjen e sendeve, furniturat, punimet dhe shërbimet e kryera për një veprimtari ekonomike, profesionale apo administrative dokumentohen në çdo rast me faturë.

*Të gjitha sa më sipër, janë rikonfirmuar me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar.*

*Bazuar në sa më lart, në kundërshtim me rregullat e plotësimit të dokumentit financiar, mandatpagesave të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit si dokument justifikues për pagesën e kësteve të apartamentit në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, iu mungon emërtimi i ndërmarrjes, që lëshon dokumentin, forma juridike e shoqërisë dhe adresa e saj (selia).*

- ii. Mandatpagesat nr. {\*\*\*}, datë 19.01.2004, nr. {\*\*\*}, datë 20.12.2005, dhe nr. {\*\*\*}, datë 18.09.2006, krijojnë bindjen se janë të parregullta, pasi nga vetë numri rendor i tyre, referuar

---

<sup>1</sup> Si është fatura, fletëhyrja, fletëdalja, mandatarkëtimi etj.

<sup>2</sup> Referuar nenit 2 të ligjit nr. 7661, datë 19.01.1993, regjimet kontabël miratohen nga Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe bazuar në nenin 3, pika “a” e ligjit nr. 7661, datë 19.01.1993, Këshilli i Ministrave miraton sistemin kontabël të përgjithshëm.

<sup>3</sup> Plani i Përgjithshëm Kontabël, faqe 12, miratuar me VKM-në nr.334, datë 09.07.1993, bazuar në ligjin nr. 7661, datë 19.01.1993 (Fletore Zyrtare nr. 11).

datave të lëshimit, ato tregojnë që janë lëshuar me një renditje të parregullt, pasi nuk krijohet bindja se shoqëria mund të lëshonte një mandat me nr. {\*\*\*} në muajin dhjetor apo me nr. {\*\*\*} në muajin shtator. Për këtë arsye, trupi gjykues krijon bindjen se edhe mandati i parë nr. 1, datë 19.01.2004, është i pabesueshëm, e për pasojë pa efekt provues.

- iii. Me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, me nr. {\*\*\*}, datë 30.06.2004, ka rezultuar se shoqëria “{\*\*\*}” ShPK është përthithur nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK. Shoqëria “{\*\*\*}” ShPK nuk ka ekzistuar pas datës 30.06.2004, pra ka humbur personalitetin juridik të saj, si rrjedhojë likuidimet e subjektit të rivlerësimit në datat 20.12.2005 dhe 18.09.2006 janë të pabesueshme.
- iv. Sipas mandatit të Bankës Credins, ka rezultuar se pagesa e fundit për likuidimin total të çmimit të apartamentit është kryer më datë 23.11.2005 dhe, për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se huaja e marrë në vlerën 25000 euro ndaj shtetases P.H., sipas kontratës me nr. {\*\*\*} rep. dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 16.08. 2006, nuk ka shërbyer për blerjen e këtij apartamenti, pasi rezulton që është marrë 9 muaj pas likuidimit të apartamentit. Për këtë arsye, nuk qëndron pretendimi i subjektit në ankim që kontrata e huas është marrë një muaj përpara pagesës së fundit për blerjen e apartamentit. Gjithashtu, deklarata për kthimin e kësaj huaje, e cila mban datën 21.08.2008, nuk është në përputhje me deklaratimet periodike të pasurisë dhe si e tillë nuk ka vlerë provuese për trupin gjykues.
- v. Sa i takon kthimit të huas, subjekti ka deklaruar marrjen e një kredie më datë 27.12.2007, pranë Raiffeisen Bank, me kohëzgjatje 84 muaj, interesi 18% në vit, kësti mujor 21017 lekë, në vlerën 1.000.000 lekë, për shlyerjen e huas së mësipërme, në vlerën 25000 euro. Nga verifikimi i kësaj kontrate, ka rezultuar se kredia është marrë për pajisje shtëpiake të subjektit të rivlerësimit.
- vi. Subjekti i rivlerësimit, siç pretendon dhe në ankim për mënyrën e likuidimit të apartamentit, nuk ka deklaruar pagesat për apartamentin në vitet 2004-2005, si dhe interesat privatë në kuptim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, në vitin 2005.
- vii. Me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 26.12.2017, të OShEE-së, kjo e fundit bën me dije se në apartamentin në rr. “{\*\*\*}” është abonent B.N., me kontratë {\*\*\*}, hapur më 12.01.2006, çka do të thotë se hapja e librezës së energjisë përkon faktikisht dhe në kohë edhe me pagesën e këstit të fundit sipas mandateve bankare.
- viii. Pretendimi i subjektit që bashkëshortja e tij, B.N., nuk është paraqitur asnjëherë pranë Bankës Credins për likuidimin e kësteve/vlerave për blerjen e apartamentit ,nuk i krijon bindjen trupit gjykues se pagesat janë bërë siç pretendon subjekti. Rezulton se nga ana e Komisionit janë vlerësuar drejt dhe në harmoni me njëra-tjetrën, shkresa nr. {\*\*\*}, datë 07.03.2018, e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe shkresa nr. {\*\*\*}, datë 12.06.2018, e Bankës Credins, nga analiza e të cilave rezulton se pagesat për këtë apartament janë bërë përmes bankës në datën 23.12.2004 në vlerën 22.000 euro, në datën 08.09.2005 në vlerën 10.000 euro, në datën 08.11.2005 në vlerën 5.000 euro dhe në datën 23.11.2005 në vlerën 4.251 euro. Për këtë arsye, është i drejtë përfundimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë se nuk ka qenë bashkëshortja e tij ajo që ka derdhur vlerat përkatëse në bankë.

40. Lidhur me pretendimin e ngritur në ankim se Komisioni nuk ka analizuar dhe nuk ka arsyetuar në vendimin përfundimtar faktet që përmbajnë deklaratat noteriale të shtetasve Xh.I., I.K. dhe A.K., në kundërshtim me nenin 49, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, *trupi gjykues vlerëson se Komisioni i ka administruar të gjitha provat në harmoni me njëra-tjetrën dhe ka dalë me vendim konkret. Në rastin në fjalë, këto deklarata i ka konsideruar të panevojshme dhe se bien në kundërshtim me prova të tjera, që provojnë të kundërtën për aq sa pretendon subjekti, siç janë vendimi i gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. {\*\*\*}, datë 02.06.2004, dhe vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. {\*\*\*}, datë 30.06.2004. Këto vendime të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë evidentojnë faktin se shoqëria “{\*\*\*}” ShPK është përthithur nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, si dhe miratimin e projektit të bashkimit me përthithje të dy shoqërive.*
41. Për sa më sipër, pretendimi i subjektit në ankim se apartamenti është likuiduar përfundimisht më datë 15.09.2006, është i pavërtetë. Zhvendosja në data e deklarimit të pagesave të apartamentit nga ana e subjektit të rivlerësimit, bëhet me qëllim që të mbulojë pagesat në vlerën prej 25000 eurosh me të ardhurat nga huaja. Për këtë arsye, si dhe referuar sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se vlera prej 25.000 euro “marrë hua” nuk mund të ketë shërbyer për pagesën e çmimit të apartamentit.
42. Nga analizimi që i bën trupi gjykues situatës financiare për vitet 2004 dhe 2005, rezulton që subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë në vlerën totale prej 5.276.966 lekësh.
43. Ndërkohë, lidhur me pretendimin në ankim të subjektit të rivlerësimit, se ai nuk i ka pasqyruar kursimet, gjendjen *cash* në deklaratat periodike vjetore të viteve 2003, 2004 dhe 2005 për shkak se nuk ka treguar kujdesin e duhur, ky mospasqyrim nuk passjell paligjshmëri të burimit, e për rrjedhojë të ardhurat nga paga kanë qenë të mjaftueshme për të kryer pagesat e apartamentit në vitet 2004 dhe 2005, *trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky pretendim i ankuesit nuk qëndron, pasi në deklaratimet e pasurisë të viteve 2003, 2004 dhe 2005, nuk pasqyrohet asnjë kursim i subjektit të rivlerësimit. Në këto deklarata, në rubrikën “pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme” kërkohet të pasqyrohet gjendja cash e subjektit, gjë e cila nuk është plotësuar nga ana e tij. Referuar nenit D, pika 3, fjalia 2 e Aneksit të Kushtetutës, që parashikon se “Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore”, duke qenë se këto kursime të subjektit nuk janë deklaruar, ato nuk mund konsiderohen si të tilla, dhe për këtë arsye nuk qëndron ky pretendim i subjektit në ankim.*
44. Lidhur me pretendimin në ankim se deklaratat për kthimin e huas ndaj shtetasës P.H. janë të panoterizuara, për faktin se kemi të bëjmë me një marrëdhënie të posaçme në kuptim të nenit 233, germa “c” e Kodit të Procedurës Civile, *trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se këto deklarata për kthim huaje nuk përputhen me deklaratimet periodike të pasurisë së subjektit të rivlerësimit si në vlerë, ashtu dhe në kohë. Gjithashtu, duke qenë se kjo hua nuk ka shërbyer për blerjen e apartamentit, pasi është marrë rreth 9 muaj pas pagimit të këstit të fundit, nuk është i besueshëm dhe nuk gjen mbështetje pretendimi i subjektit të rivlerësimit për kthimin e kësaj huaje në vlerat dhe kohën e pretenduar prej tij.*
45. Lidhur me këtë pasuri, u morën në shqyrtim aktet e mëposhtme.
- i. Vërtetim hipotekor nr. {\*\*\*}, datë 25.04.2011, për apartament banimi me sipërfaqe 99,4 m<sup>2</sup> në

pronësi të Arben dhe B.N. dhe hartë treguese.

- ii. Kontratë shitjeje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 19.3.2011, çmimi 41.251 euro, me shitës shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, vërtetim hipotekor nr. {\*\*\*}, datë 18.2.2011, në pronësi të “{\*\*\*}” ShPK, e noterizuar, hartë treguese dhe planimetri, dokument identifikimi.
- iii. Kontratë paraprake shitjeje, datë 19.01.2004, me palë blerëse B.N. (Gj.) dhe shitëse shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, planimetri dhe 3 mandatpagesa, me vlerë totale 41.335 euro, të njehsuara me origjinalin.
- iv. Kontratë kredie bankare me “Raiffeisen Bank”, datë 27.12.2007, shuma 1.000.000 lekë (*qëllimi: për pajisje shtëpiake*), e noterizuar + vërtetim i datës 14.01.2010 nga “Raiffeisen Bank” se nuk ka detyrim kredie + kërkesë dhe mandatpagesë e shlyerjes totale të kredisë 847.663 lekë, datë 08.01.2010, të njehsuara me origjinalin.
- v. Kontratë huaje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 16.08.2006, shuma 25.000 euro.
- vi. Deklaratë e thjeshtë për kthim huaje, datë 21.08.2008, ku konfirmohet likuidimi i shumës 25.000 euro. Njehsimi me origjinalin më datë 20.01.2017.
- vii. Vërtetim i njësisë me origjinalin nr. {\*\*\*} rep., datë 21.01.2017, për dokumente në gjuhën italiane të shtetasve P.H. dhe P.H., ku janë noterizuar dokumente me të dhëna financiare në gjuhën italiane për shtetasen P.H., me kod fiskal {\*\*\*} për vitet 2002, 2003, 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2014, si dhe për bashkëshortin e saj, P.H., me kod fiskal {\*\*\*} për vitet 2003-2013. Gjithashtu, gjenden në këtë njësim edhe dokumente të një ndërmarrjeje individuale me nr. administrativ ekonomik {\*\*\*} në Breshia, datë 09.05.2007, si dhe dokumente identiteti familjare italiane.
- viii. Vendimi nr. {\*\*\*}, datë 02.06.2004, i Gjykatës së Tiranës, me anë të të cilit miratohet projekti i bashkimit me përthithje të dy shoqërive “{\*\*\*}” ShPK dhe “{\*\*\*}” ShPK dhe vendimi nr. {\*\*\*}, datë 30.06.2004, me anë të të cilit është miratuar raporti i ekspertit kontabël për bashkimin me përthithje të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe “{\*\*\*}” ShPK, si dhe kalimin e plotë të trashëgimisë së shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK te shoqëria përfituese “{\*\*\*}” ShPK.
- ix. Shkresa nr. {\*\*\*}, datë 17.01.2018, e ZVRPP-së Tiranë, ku konfirmohet apartamenti me sipërfaqe 99 m<sup>2</sup>, me nr. {\*\*\*}, Zona Kadastrale (në vijim ZK) {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, f. {\*\*\*}, në pronësi të Arben e B.N., me adresë: rruga “{\*\*\*}”, godina “{\*\*\*}”, hyrja {\*\*\*}, ap. {\*\*\*}, Tiranë.
- x. Shkresa nr. {\*\*\*}, datë 26.12.2017, e OShEE-së bën me dije se në apartamentin në rrugën “{\*\*\*}” është abonent B.N., me kontratë {\*\*\*}, hapur më 12.01.2006.
- xi. Shkresa nr. {\*\*\*}, datë 07.03.2018, e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, e cila konfirmon se kontrata paraprake e shitjes me shoqërinë nga ana e bashkëshortëve Nela, është lidhur më datë 19.01.2004 dhe pagesat janë bërë me këste në “Credins Bank”, në vlerën 41.251 euro, të ndara me këste si më poshtë:
  - datë 23.12.2004, shuma 22.000 euro;
  - datë 08.09.2005, shuma 10.000 euro;
  - datë 08.11.2005, shuma 5.000 euro;
  - datë 23.11.2005, shuma 4.251 euro.
- xii. Shkresë nr. {\*\*\*}, datë 07.06.2018, e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK.

- xiii. Vërtetimi, datë 17.01.2017, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier (viti 2003 - 2005, shuma 1.584.876 lekë).
  - xiv. Vërtetimi, datë 11.01.2017, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë (viti 1998 - 2003, shuma 1.914.274 lekë).
  - xv. Vërtetim për të ardhura nga paga e bashkëshortes si specialiste në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës (në vijim MTI), viti 2000, shuma 102.714 lekë.
  - xvi. Vërtetim për të ardhurat nga paga e bashkëshortes si specialiste në MTI, viti 2001, shuma 156.244 lekë.
  - xvii. Vërtetim për të ardhurat nga paga e bashkëshortes si specialiste në MTI, viti 2002, shuma 293.747 lekë.
  - xviii. Vërtetim për të ardhurat nga paga e bashkëshortes si specialiste në MTI, viti 2003, shuma 253.693 lekë.
  - xix. Vërtetim për të ardhurat nga paga e bashkëshortes si specialiste në MTI, viti 2004, shuma 280.281 lekë.
  - xx. Shkresat nga institucionet bankare që konfirmojnë gjendjen e likuiditetit të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes për periudhën që janë shlyer kështu për apartamentin.
  - xxi. Shkresë nr. {\*\*\*}, datë 12.06.2018, e “Credins Bank”.
  - xxii. Deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep. dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 08.06.2018, e shtetasve I.K. dhe Xh.I..
  - xxiii. Deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep. dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 08.06.2018, e shtetasit A.K..
  - xxiv. Deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 12.06.2018, e shtetasës B.H..
  - xxv. Tri kontrata shitjeje paraprake të ngjashme të lidhura me persona të tjerë.
46. *Për këtë pasuri, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, kanë bërë deklaram të rremë dhe kanë mungesë burimi financiar të ligjshëm për të justifikuar pasurinë, sipas nenit 61, pika 3 dhe nenit 33, pika 5, gjerat “b” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016.*
47. **Për pasurinë 2:** *banesë 136,9 m<sup>2</sup>, ndodhur në Lanabregas, Tiranë, regjistruar në ZVRPP, më datë 10.04.2015, banesë e legalizuar sipas lejes së legalizimit nr. {\*\*\*}, datë 31.12.2014, ku në pronësi të Arben Nela përfundimisht është regjistruar banesa me sipërfaqe 121,6 m<sup>2</sup>, vërtetuar me certifikatën e pronësisë nr. {\*\*\*}, datë 16.12.2015.*
48. Subjekti i rivlerësimit Arben Nela, këtë pasuri e ka deklaruar në deklaratën e interesave privatë në vitin 2010 si vijon: “Një banesë me sipërfaqe 93 m<sup>2</sup>, së bashku me truallin me sipërfaqe 1090 m<sup>2</sup>, e ndodhur në adresën “{\*\*\*}”, Tiranë. Kjo pasuri është e peregjistruar në ZVRPP. Pjesa që zotëron, 30%. Si burim krijimi për këtë pasuri janë deklaruar kursimet e prindërve të subjektit. Sipërfaqja e truallit prej 1090 m<sup>2</sup> pretendohet të jetë blerë në vitin 1994 nga babai i subjektit R.N., ndërkohë që banesa, sipas subjektit të rivlerësimit, është ndërtuar në vitin 2001 me kursime të prindërve të subjektit. Për këtë pasuri, subjekti dhe babai i tij kanë kryer procedurën e vetëdeklarimit për legalizim në Njësinë Bashkiake Nr. 1, Tiranë.

*Në deklaratën e interesave privatë periodikë/vjetorë të vitit 2014 deklarohet: “Legalizuar banesa e deklaruar më parë, sipas lejes së legalizimit nr. {\*\*\*}, datë 31.12.2014. Duke qenë se mbi katin*



e parë (të deklaruar më parë nga ana ime), janë ndërtuar edhe dy kate të tjera nga vëllezërit e mi S.N. dhe R.N., është legalizuar godina me tri kate”.

*Në deklaratën e interesave privatë periodikë/vjetorë të vitit 2015* deklarohet: “Regjistruar banesa e legalizuar (leja e legalizimit nr. {\*\*\*}, datë 31.12.2014, e deklaruar më parë), në ZVRPP Tiranë, sipas certifikatës së pronësisë nr. {\*\*\*}, datë 16.12.2015. Sipërfaqja 120,60 m<sup>2</sup>, vendndodhja Lanabregas Tiranë”.

*Ndërsa në deklaratën e pasurisë (vetting) 2017* deklarohet: “Banesë me sipërfaqe 136,9 m<sup>2</sup>, ndodhur në Lanabregas, Tiranë, regjistruar në ZRPP më datë 10.04.2015, me nr. pasurie {\*\*\*}, në zonën kadastrale {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, f. {\*\*\*}, në pronësi të Arben Nela. Kjo banesë është legalizuar sipas lejes së legalizimit nr. {\*\*\*}, datë 31.12.2014. Banesa është ndërtuar gjatë viteve 1999-2001 nga prindërit e mi, me kursimet e tyre (fillimisht si ndërtesë me një kat). Nga kjo pasuri, një sipërfaqe prej 15,3 m<sup>2</sup> (ambient ndihmës) i është dhuruar babait R.N.. Përfundimisht, në pronësi të Arben Nela është regjistruar banesa me sipërfaqe 121,6 m<sup>2</sup>, vërtetuar me certifikatën e pronësisë nr. {\*\*\*}, datë 16.12.2015.”

49. Trupi gjykues, lidhur me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit për këtë pasuri konstaton:

- i. Nisur nga deklaratimet e vetë subjektit të rivlerësimit, ka mospërputhje të këtyre deklaratimeve, për sa i përket sipërfaqes së truallit të kësaj banese. Në vitin 2010 subjekti ka deklaruar blerjen e truallit me sipërfaqe 1090 m<sup>2</sup> nga babai i tij dhe me pjesë takuese të subjektit të rivlerësimit 30%, ndërsa në vitin 2017 nuk deklarohet asgjë lidhur me truallin e kësaj pasurie.
- ii. Në vitin 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar një banesë me sipërfaqe 93 m<sup>2</sup>, ndërtuar në vitin 2001. Gjithashtu, në këtë deklaratim subjekti ka deklaruar se ka kryer procedurat e vetëdeklarimit për legalizim në Njësinë Bashkiake nr. 1, Tiranë, për rrjedhojë subjekti i rivlerësimit ka qenë posedues i kësaj banese dhe truallit 1090 m<sup>2</sup>, dhe për periudhën që ka qenë subjekt deklarues deri në vitin 2010, kjo pasuri në posedim nuk është deklaruar nga ana e tij. Subjekti i rivlerësimit duhej të kishte deklaruar në përputhje me nenin 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, i cili specifikon se *subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në ILDKPKI [...] pasuritë dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil*.
- iii. Referuar pretendimit të subjektit, se kati i parë me sipërfaqe 93 m<sup>2</sup> dhe trualli prej 1090 m<sup>2</sup> është ndërtuar/blerë nga prindërit e tij, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson të përlllogaritë të ardhurat e babait të subjektit të rivlerësimit, si person tjetër i lidhur, sipas shkresës së ISSh-së nr. {\*\*\*} prot., datë 12.06.2018, bashkëlidhur së cilës janë dërguar vërtetimet përkatëse për të ardhurat neto të R.N., sipas viteve. Nga kjo përlllogaritje rezultoi se të ardhurat totale neto të R.N., nga viti 1994-2001, janë 1.166.232 lekë. *Lidhur me të ardhurat e nënës së subjektit të rivlerësimit*, trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor të ardhurat e pretenduara në kuptim të nenit D, pika 3, fjalja 2 e Aneksit të Kushtetutës, ku parashikohet se *pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore*. Për këtë arsye, të ardhurat e pretenduara në emër të nënës së subjektit të rivlerësimit nuk mund të merren në konsideratë në analizën ekonomike në Kolegj.
- iv. Referuar pretendimit në ankim se nëna dhe vëllezërit e subjektit nuk kanë qenë ndonjëherë subjekt i deklarinimit të pasurisë dhe për këtë arsye parashikimi kushtetues i nenit D, pika 3, fjalja e dytë e Aneksit të Kushtetutës, nuk gjen zbatim, trupi gjykues vlerëson se nuk qëndron

ky pretendim i ankuesit, pasi këta persona janë vlerësuar si persona të lidhur të subjektit të rivlerësimit në kuptim të nenit 3, pikat 13 dhe 14, nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 3, pika 11 e ligjit nr. 9367, datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar. Për rrjedhojë, ata kanë detyrimin ligjor të justifikojnë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

- v. Nga analiza ekonomike rezultoi se prindërit e subjektit të rivlerësimit me të ardhurat nga burime të ligjshme të realizuara për periudhën 1999-2001, në shumën 1.166.232 lekë, nuk justifikojnë në vlerën 3.065.819 lekë shpenzimet për konsum të përllogaritura për familje me pesë anëtarë në shumën 769.713 lekë, si dhe investimin në shumën 3.462.338 lekë, të bërë për ndërtimin e katit të parë të banesës, përllogaritur kjo e fundit sipas Vendimit nr. 214, datë 28.04.1999, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave mesatare të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit K”. Si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë. Edhe në qoftë se e marrim për bazë pretendimin e subjektit se kostoja e ndërtimit për katin e parë ka qenë 508.784 lekë, sipas një akt ekspertize tekniko-ekonomike të ekspertes V.G. dhe jo 3.400.000 lekë, përsëri subjekti ka mungesë burimi financiar të ligjshëm për të justifikuar pasurinë.
- vi. Lidhur me pretendimin tjetër në ankim se kati i dytë dhe kati i tretë janë ndërtuar nga vëllezërit e tij, S. dhe R.N., trupi gjykues, referuar analizës financiare të kryer për të vlerësuar mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme të personave të tjerë të lidhur me subjektin (vëllezërit), doli në përfundimin se nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar ndërtimin e dy kateve përkatësisht. Nga përllogaritja që iu bë koston për sipërfaqen e ndërtimit 136,90 m<sup>2</sup> (një kat), bazuar në mesataren e kostove për sipërfaqe ndërtimi për Tiranën, për vitet 2005-2013, të përcaktuara në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave<sup>4</sup> në vlerën ~ 26.340 lekë/m<sup>2</sup>, ajo rezultoi në vlerën 3.605.900 lekë. Nga analiza financiare e kryer, S.N. nuk rezulton të ketë gjeneruar të ardhurat nga burime të ligjshme për periudhën 2005-2013, pasi referuar vërtetimit nr. {\*\*\*} prot., datë 16.05.2018, të Drejtorisë së Arkivit Qendror (në vijim DAQ), Tiranë, nuk janë paguar detyrime tatimore për këtë punonjës nga shoqëria "{\*\*\*}" ShPK për periudhën shtator 2007 - tetor 2012. Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 11.03.2018, dhe shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 18.04.2018, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Tiranë vërteton se shtetasi S.N., i regjistruar si subjekt me emër tregtar {\*\*\*} ShPK e NIPT {\*\*\*}, nuk ka kryer deklarata për tatimin mbi fitimin për vitet 2010, 2011 dhe 2012, si dhe nuk ka bërë pagesa kontributesh për periudhën korrik 2010 – nëntor 2012. Për sa i përket aktivitetit me objekt “avokat”, të regjistruar më 10.10.2012, me NIPT {\*\*\*}, personi fizik “S.N.” ka deklaruar për vitin 2012 humbje në vlerën 5.037 lekë dhe për vitin 2013, ka realizuar fitim neto në vlerën 166.701 lekë.

Për sa u përket të ardhurave nga burime të ligjshme të personit tjetër të lidhur R.N. (vëllait), nga analiza financiare e kryer, R.N. nuk rezulton të ketë gjeneruar të ardhura nga burime të ligjshme për periudhën 2005-2013, pasi referuar vërtetimit nr. {\*\*\*} prot., datë 16.05.2018, të DAQ Tiranë, nuk janë paguar detyrime tatimore për këtë punonjës nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK për periudhën mars 2007 - dhjetor 2011 dhe se, për muajin janar 2012, ky subjekt nuk ka

---

<sup>4</sup> Sipas udhëzimit nr.1, datë 04.03.2004, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit "K", kosto mesatare e ndërtimit, për sip. ndërtimi, për Tiranën, ka qenë për vitin 2004, 24.446 leke/m<sup>2</sup>, për vitin 2005, referuar udhëzimit nr.5, datë 23.11.2005, ka qenë 25,168 leke/m<sup>2</sup>, referuar udhëzimit nr.5, datë 07.09.2006, ka qenë 25,262 leke/m<sup>2</sup>, referuar udhëzimit nr.2, datë 04.04.2007, ka qenë 24,993 leke/m<sup>2</sup>, referuar udhëzimit nr.1, datë 20.08.2008, ka qenë 27,439 leke/m<sup>2</sup>.

dërguar listat e punëmarrësve. Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 07.03.2018, ISSh vërteton të jenë paguar detyrimet e kontributet nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, për punëmarrësin R.N. prej shkurtit 2012 deri në muajin prill 2013, dhe prej shkurtit 2015 deri në dhjetor 2017. Për këtë punëmarrës, rezulton të jenë derdhur detyrime në sigurime dhe tatime prej shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, nga personi fizik “R.N.”, i regjistruar më 20.09.2016, me NIPT {\*\*\*}, dhe “Reparti Ushtarak {\*\*\*}”, prej shtatorit 2016 e në vijim.

Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin se S. dhe R.N. kanë mungesë burimesh financiare të ligjshme për të kryer investimin në shumën 3.605.900 lekë secili për ndërtimin e katit të dytë dhe të tretë përkatësisht, në banesën në Lanabregas, Tiranë.

- vii. Nisur nga pretendimi i subjektit se vëllezërit e tij, S. dhe R.N, nuk janë në cilësinë e personave të tjerë të lidhur, trupi gjykues konstaton se procedura e vetëdeklarimit për legalizim, leja e legalizimit dhe certifikata e pronësisë janë në emrin e babait të subjektit R.N. dhe në emrin e subjektit Arben Nela. Pasi këta të fundit janë pajisur me certifikatë pronësie të pasurisë në fjalë, kanë bërë pjesëtimin e pasurisë ndërmjet tyre, përkatësisht Arben Nela katin e parë të banesës trekatëshe, babai i tij R.N. ka marrë katin e dytë dhe katin e tretë në pronësi. Pasi u realizua pjesëtimi i pasurisë, babai i subjektit R.N., me anë të kontratave të dhurimit, i ka dhuruar katin e dytë të birit S.N. dhe 1/2 e katit të tretë të birit R.N, me kusht. Fillimisht banesa trekatëshe është regjistruar në ZVRPP Tiranë në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe babait të tij. Duke qenë se subjekti pranon në përgjigjet ndaj pyetësorëve të Komisionit, si dhe në ankim se kati i dytë dhe i tretë janë ndërtuar nga vëllezërit e tij, në këtë kuptim këta të fundit rezultojnë të jenë dhurues të kontributit për dy nga tri katet e objektit, sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, dhe rrjedhimisht konsiderohen si persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit.
- viii. Mbi bazën e lejes së legalizimit nr. {\*\*\*}, datë 31.12.2014, subjekti së bashku me babain e tij kanë legalizuar objektin me sipërfaqe 136,9 m<sup>2</sup> (njollë) dhe sipërfaqe totale e ndërtimit 410,7 m<sup>2</sup>, dhe truallin prej 300 m<sup>2</sup>. Me kontratën e kalimit të pronësisë të parcelës ndërtimore nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 31.12.2014, ALUIZNI i kalon subjektit Arben Nela dhe babait R.N. në pronësi parcelën ndërtimore, me sipërfaqe 300 m<sup>2</sup>, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 513, datë 01.08.2012. Në kontratën e pjesëtimin vullnetar të datës 08.04.2015, subjekti i rivlerësimit dhe babai i tij kanë ruajtur nga 1/2 pjesë ideale takuese në truallin, mbi të cilin është ndërtuar objekti, por në deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017, nga subjekti nuk është deklaruar kjo sipërfaqe trualli 300 m<sup>2</sup>.
- ix. Me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 17.01.2018, të ZVRPP-së, Tiranë konfirmohet se në pronësi të subjektit të rivlerësimit Arben Nela është:
- a) një apartament 99,4 m<sup>2</sup>, në bashkëpronësi me bashkëshorten, në ZK {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, f. {\*\*\*};
  - b) një sipërfaqe trualli prej 300 m<sup>2</sup> në ZK {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, f. {\*\*\*};
  - c) një apartament me sipërfaqe 121,6 m<sup>2</sup> në ZK {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, f. {\*\*\*};
  - ç) një apartament me sipërfaqe 15,30 m<sup>2</sup> në ZK {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, f. {\*\*\*}, pasuri e transkriptuar.

Ndërsa me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 31.01.2018, të ZVRPP-së, Tiranë, nga i njëjti nëpunës i saj, pra vetëm 14 ditë më vonë, ndërkohë që nuk është regjistruar në ZVRPP Tiranë asnjë veprim juridik në lidhje me pasuritë e subjektit të rivlerësimit Arben Nela, konfirmohet se në pronësi të tij janë:

- a) një apartament 99,4 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie {\*\*\*} në bashkëpronësi me bashkëshorten, ndodhur në ZK {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, f. {\*\*\*};
  - b) një apartament me sipërfaqe 121,6 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie {\*\*\*}, ZK {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, f. {\*\*\*}, me adresë: Lanabregas, Dajt, Tiranë;
  - c) një apartament me sipërfaqe 15,30 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie {\*\*\*}, ndodhur në ZK {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, f. {\*\*\*}, pasuri e transkriptuar.
50. Pra, në shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 31.01.2018, të ZVRPP-së, Tiranë nuk pasqyrohet trualli 300 m<sup>2</sup> në pronësi të subjektit të rivlerësimit, në mungesë të një akti juridik për ta hequr këtë pasuri nga pronësia e subjektit të rivlerësimit.
  51. Lidhur me pretendimin e subjektit se, përmes shkresës së ZVRPP Tiranë me nr. {\*\*\*} prot., datë 14.06.2018, sqarohet se kartela e pasurisë për truallin 300 m<sup>2</sup> nuk është më aktive, pasi është mbyllur dhe ndarë në tri pasuri bija me zërin kadastral “apartamente”, trupi gjykues nisur nga shqyrtimi gjyqësor i provave, konstaton se nuk ka një veprim juridik, mbi bazën e të cilit është bërë mbyllja e kartelës së pasurisë truall 300 m<sup>2</sup>, nga ZVRPP Tiranë, pasi referuar kontratës së pjesëtimit vullnetar të datës 08.04.2015 midis Arben Nelës dhe R.N., palët kanë vendosur të ruajnë secili pjesën zotëruese prej 1/2, lidhur me truallin me sipërfaqe 300 m<sup>2</sup>. Pra, rezulton se pas kontratës së pjesëtimit vullnetar të datës 08.04.2015, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit ka ruajtur 1/2 e pjesës ideale takuese, nuk ka më veprime juridike të kryera në lidhje me disponimin e truallit prej 300 m<sup>2</sup>.
  52. Nisur nga pretendimi i subjektit të rivlerësimit se mosdeklarimi në mënyrë specifike i truallit 300 m<sup>2</sup>, përbën pasaktësi por jo fshehje, dhe si i tillë nuk mund të jetë shkak për shkarkim nga detyra, në përputhje edhe me qëndrimin e mbajtur në vendimin nr. 4, datë 26.07.2018, të Kolegjit, *trupi gjykues vlerëson se mosdeklarimi i truallit prej subjektit të rivlerësimit përbën fshehje të pasurisë, pasi ai nuk është deklaruar në asnjë moment prej tij, pavarësisht se pas aktit të pjesëtimit të pasurisë sipas kontratës së pjesëtimit vullnetar të datës 08.04.2015, që është dhe veprimi i fundit juridik mbi truallin, subjekti i rivlerësimit ruante 1/2 e pjesës ideale takuese mbi këtë truall.*
  53. Lidhur me pretendimin se është cenuar parimi i proporcionalitetit në dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit Arben Nela, *trupi gjykues vlerëson se masa e dhënë është në përputhje me atë çfarë ka rezultuar nga gjykimi i çështjes. Dhënia e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra është një masë proporcionale dhe ligjore në raport me verifikimin e shkaqeve të tilla, si: deklarimi i pasaktë i pasurisë, fshehja e pasurisë, mungesa e burimit të ligjshëm për të justifikuar pasuritë etj. Për sa më sipër, nuk qëndron ky pretendim i ankuesit.*
  54. Në përfundim, referuar gjithë sa më sipër, lidhur me truallin 300 m<sup>2</sup>, *trupi gjykues vlerëson se nga ana e subjektit të rivlerësimit ka pasur përpjekje për fshehje të pasurisë nga ana e tij, në kuptim të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.*
  55. Lidhur me pretendimin në ankim se subjekti i rivlerësimit Arben Nela është dekretuar prokuror me dekretin nr. {\*\*\*}, datë 05.06.2002, ndërsa kjo pasuri është ndërtuar në vitin 1999-2001 nga prindërit e subjektit me kursimet e tyre, *trupi gjykues vlerëson se subjekti ka qenë posedues i kësaj pasurie dhe vazhdon ta ketë në pronësi edhe aktualisht, çka do të thotë se ai ka pasur detyrimin ligjor të justifikojë pasurinë me burime financiare të ligjshme. Fakti që ai është dekretuar prokuror në vitin 2002, ndërkohë që objekti është ndërtuar në vitin 2001 nuk e përjashton atë nga detyrimi si më sipër.*
  56. Lidhur me këtë pasuri, u morën në shqyrtim aktet si më poshtë:

- i. Shkresë, nr. {\*\*\*} prot., datë 31.01.2018, e ZVRPP-së Tiranë, ku konfirmohet apartament me sipërfaqe 121,6 m<sup>2</sup>, me nr. {\*\*\*}, ZK {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, f. {\*\*\*}, në pronësi të Arben Nelës. Adresa: Lanabregas, Dajt, Tiranë.
- ii. Shkresë nr. {\*\*\*}, datë 17.01.2018, e ZVRPP-së Tiranë ku konfirmohet se në pronësi të Arben Nelës është një apartament me sipërfaqe 121,6 m<sup>2</sup> në ZK {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, f. {\*\*\*}; një apartament 99,4 m<sup>2</sup> në bashkëpronësi me bashkëshorten në ZK {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, f. {\*\*\*}, si dhe një sipërfaqe truall prej 300 m<sup>2</sup> në ZK {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, f. {\*\*\*}.
- iii. Shkresë nr. {\*\*\*}, datë 29.12.2014, e ZVRPP Tiranë, ku konstatohet se: *Sipërfaqja në zonën kadastrale {\*\*\*}, {\*\*\*}, prek pasurinë nr. {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, f. {\*\*\*}, lloj pasurie “pyll”, me sipërfaqe 831.036 m<sup>2</sup>, ref. {\*\*\*} në pronësi shtet dhe me Vendimin nr. 513, datë 01.08.2012, të Këshillit të Ministrave është vendosur kalimi në pronësi të subjektit dhe të të atit, i sipërfaqes së parcelës ndërtimore me sipërfaqe 300 m<sup>2</sup>.*
- iv. Shkresë e ZVRPP-së Tiranë nr. {\*\*\*}, datë 14.06.2018, e cila konfirmon se pasuria {\*\*\*} - truall sipërfaqe 300 m<sup>2</sup>, nuk është pasuri aktive, pasi kjo kartelë është mbyllur dhe ndarë në tri pasuri bija, me zërin kadastral “apartamente”.
- v. Kontrata e kalimit të pronësisë së parcelës, me nr. {\*\*\*} rep. dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 31.12.2014, ku Arben dhe R.N. marrin në pronësi parcelën ndërtimore me sipërfaqe 300 m<sup>2</sup>, me çmim 312.000 lekë, ku janë paguar 112.320 lekë dhe shuma 156.000 është paguar me bono privatizimi.
- vi. Kontrata e pjesëtimit vullnetar, e datës 08.04.2015, midis Arben Nelës dhe R. N., në të cilën citohet se *palët deklarojnë se janë dakord që truallin me sipërfaqe prej 300 m<sup>2</sup> të vazhdojë të mbetet i përbashkët, ku secili zotëron 1/2 pjesë.*
- vii. Aktekspertizë tekniko-ekonomike e ekspertës V. G., sipas së cilës vlera e llogaritur për ndërtimin e katit të parë është 508.784 lekë, dhe jo 3.400.000 lekë.
- viii. Vërtetim, lëshuar nga subjekti fizik M.H., me NIPT {\*\*\*}, sipas të cilit nëna e subjektit të rivlerësimit ka punuar pranë këtij subjekti.
- ix. Vërtetim nga Drejtoria Arsimore Rajonale e Qarkut Tiranë, nr. {\*\*\*} prot., datë 06.03.2013, në të cilin shpjegohet se për periudhën 1967-2013 (*me përjashtim të viteve 1969-1970 dhe 1982*), i ati i subjektit të rivlerësimit, R.N., ka punuar si mësues në disa shkolla të arsimit 8-, 9-vjeçar në qarkun e Tiranës.
- x. Shkresë e ISSh, nr. {\*\*\*} prot., datë 12.06.2018, për të ardhurat neto të R.N.
- xi. Deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 29.12.2016, e R.dhe F.N.
- xii. Shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 07.02.2018, nga ALUIZNI, Drejtoria Kamëz - Vorë, së bashku me dokumentacionin shoqërues.
- xiii. Shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 17.05.2018, e Drejtorisë së Arkivit Qendror, Dega Tiranë, që tregon se për F.N. nuk administrohen listëpagesa për periudhën 1999-2003.
- xiv. Shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 23.12.2017, e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.
- xv. Dokumente të dërguara nga ana e subjektit me anë të postës elektronike, në prill 2018.
- xvi. Shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit me anë të postës elektronike.

xvii. Deklarimet periodike të pasurisë ndër vite dhe deklarata e pasurisë (vetting) 2017.

57. Në përfundim, për këtë pasuri, trupi gjykues i Kolegjit, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, ka mungesë burimi financiar të ligjshëm për të justifikuar pasurinë dhe ka kryer fshehje të pasurisë, sipas nenit 61, pika 3 dhe nenit 33, pika 5, gjerat “b” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016.
58. **Për pasurinë 3:** apartament, me sipërfaqe 67,6 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, me nr. pasurie {\*\*\*}, në zonën kadastrale {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, faqe {\*\*\*}, në pronësi të bashkëshortes, B.N., me vlerë 52.677 euro, pjesa takuese 100 %.
59. Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 17.01.2018, e ZVRPP-së Tiranë, ka rezultuar se apartamenti i mësipërm, me sipërfaqe 67,6 m<sup>2</sup> është në pronësi të shtetases, B.N., bashkëshorte e subjektit të rivlerësimit Arben Nela.
60. Për të bërë analizën ligjore dhe financiare për mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie, trupi gjykues mori në shqyrtim burimin e krijimit të saj. Sipas deklaramit të personit të lidhur, rezulton se çmimi i këtij apartamenti është në vlerën 52.677 euro. Për blerjen e këtij apartamenti, kanë rezultuar dy burime krijimi të deklaruara: hua e dhënë nga motra e personit të lidhur, P.H., në vlerën 40.000 euro dhe pjesa tjetër, prej 12.677 eurosh, nga kursimet familjare të saj.
61. Referuar burimit të parë të dekluar, nga shqyrtimi gjyqësor, kontrata e huas mes shtetases P.H., në cilësinë e huadhënëses, dhe B.N. në cilësinë e huamarrëses, rezulton të jetë lidhur më datë 21.08.2012.
62. Në këtë kontratë huaje është përcaktuar mënyra e shlyerjes së saj, pjesë-pjesë, personit tjetër të lidhur, B.N., gjatë një periudhe njëvjeçare. Pra, vlera 40.000 euro rezulton të jetë dhënë duke filluar nga gushti i vitit 2011. Dhënia e vlerave të caktuara nuk rezulton të jetë dekluar nga personi i lidhur në deklarimin periodik të pasurisë të vitit 2011, detyrim i cili rrjedh nga neni 4, germa “d” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.
63. Lidhur me pjesën tjetër të burimit të kësaj pasurie, që janë 12.677 euro nga kursimet familjare, të ardhura nga licenca profesionale e B.N. dhe të ardhurat e saj dhe të subjektit të rivlerësimit nga pagat, trupi gjykues vlerëson se të ardhurat e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, nuk mund të merren në konsideratë, pasi subjekti i rivlerësimit dhe kompania nuk janë të besueshëm në deklarimet e bëra.

Me vërtetimin e datës 29.03.2018, shoqëria deklaroi se ka paguar B.N. dhe ka mbajtur tatimin në burim. Ndërkohë, me shkresën e datës 02.10.2017, ka deklaruar se pagesën e tatimeve për B.N. e ka kanalizuar në bilanc, në zërin “furnitura, nën trajtime dhe shërbime” dhe “shpenzime të tjera”. Me shkresën e Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj nr. {\*\*\*} prot., datë 16.03.2018, provohet se nuk është dekluar dhe as paguar tatim në burim për këto të ardhura apo për kontratën individuale të punës mes shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe B.N.

Në fund, vetë subjekti i rivlerësimit, përmes ankimit, pohon se pagesa e tatimeve për këto të ardhura është bërë pikërisht me urdhërpagesën KIB nr. {\*\*\*}, datë 25.06.2018. Për sa më sipër, tatimet e paguara gjatë procesit të rivlerësimit, për të ardhura të viteve 2006-2012, nuk e bindin

trupin gjykues për ligjshmërinë e këtyre të ardhurave, pasi duket qartë që kjo pagesë është bërë për efekt të procesit të rivlerësimit.

64. Trupi gjykues analizoi mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, për të krijuar kursime në vlerën 12.677 euro, të përdorura për likuidimin tërësor të apartamentit të banimit me sipërfaqe 67,60 m<sup>2</sup>, më datë 03.05.2013. Subjekti nuk ka deklaruar kursime deri në vitin 2010. Vlerat 3.000 euro dhe 2.000 euro, të depozituara në llogari bankare të personit të lidhur, siç janë deklaruar nga subjekti në deklaratat periodike të vitit 2010 dhe 2011 përkatësisht, nga analiza e lëvizjeve të llogarisë, rezulton të mos jenë përdorur për këtë qëllim, por për pagesa të tjera, dhe nuk kanë qenë gjendje në llogari më 31 dhjetor të viteve në të cilat janë deklaruar. Duke qenë se subjekti deklaroi krijimin e një depozite në emër të personit të lidhur në vlerën 860.000 lekë dhe kursime *cash* nga paga, në vlerën 200.000 lekë në deklaratën periodike të vitit 2012, të cilat pretendon t'i ketë përdorur për likuidimin tërësor të apartamentit, në përfundim, bazuar në të dhënat e pasqyruara si më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, bashkëshortja B.N., kanë mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën 694.183 lekë për të justifikuar krijimin e kursimeve prej 12.677 eurosh, të përdorura për likuidimin tërësor të apartamentit të banimit me sipërfaqe 67,60 m<sup>2</sup>.
65. Lidhur me pretendimin e ngritur në ankim për mënyrën e likuidimit të huas në vlerën 40.000 euro, të marrë nga shtetasja P.H., person tjetër i lidhur, nga analizimi që trupi gjykues i bëri situatës financiare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij si person i lidhur me të, rezulton se ata kanë mungesë të burimit financiar të ligjshëm për vitet 2013 dhe 2014 për kthimin e kësaj huaje.
66. Lidhur me këtë pasuri, u morën në shqyrtim aktet si më poshtë:
  - i. Shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 17.01.2018, e ZVRPP Tiranë, që konfirmon se apartamenti 67,6 m<sup>2</sup> është në pronësi të B.N.
  - ii. Shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 10.05.2017 e Drejtorisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave (në vijim DPPP).
  - iii. Kontratë huaje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 21.08.2012, për shumën 40.000 euro, në të cilën vërtetohet se shuma e mësipërme i është dorëzuar personit tjetër të lidhur pjesë-pjesë, gjatë një periudhe njëvjeçare.
  - iv. Deklaratë kthim detyrimi, e thjeshtë (e njëzuar me origjinalin, por jo deklaratë noteriale), midis znj. P.H. dhe znj. B.N.
  - v. Përgjigje të pyetësorit të Komisionit, ku subjekti i rivlerësimit deklaroi se në vitin 2013, për shkak të përmirësimit të gjendjes shëndetësore të bashkëshortes, nuk ishte e nevojshme të bëhej transplant dhe paratë e marra hua nga shtetasja P.H. nuk do të përdorehin më për këtë qëllim.
  - vi. Përgjigje të pyetësorit të datës 21.03.2018, konkretisht pyetjes nr. 7, ku subjekti i rivlerësimit deklaroi se shuma prej 20.000 eurosh i është dhënë shtetasës M.Xh. (person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit), deklaruar para noterit më datë 14.09.2012, me qëllim transfertën e kësaj shume për pagim shpenzimesh mjekësore, ndërkohë që kjo shumë, në të njëjtën datë, është vendosur në depozitë me afat 1-vjeçar në “Raiffeisen Bank”, me interes vjetor 2,7% nga shtetasja M.Xh.

- vii. Kontratë për zëvendësim kreditori nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 10.05.2013, midis M.Xh. dhe B.N., për një apartament, me palë të tretë shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK.
  - viii. Aktmarrëveshje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 13.07.2010, mes shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe shtetases M.Xh., në cilësinë e porositëses së apartamentit në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë.
  - ix. Kontratë shitblerjeje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.05.2013, midis shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe B.N. për shitjen e apartamentit me sipërfaqe 67,6 m<sup>2</sup> në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë.
  - x. Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 16.03.2018, e Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj (fashikulli 7, f. 718).
  - xi. Vërtetim i datës 29.03.2018 i “{\*\*\*}” ShPK për pagesat e bëra për B.N..
  - xii. Shkresë e datës 02.10.2017 e “{\*\*\*}” ShPK për pagesat për B.N. dhe zërin në bilanc të tyre.
  - xiii. Urdhërpagesë {\*\*\*}, datë 25.06.2018 i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK për pagesën e tatimit mbi të ardhurat e B.N..
67. *Në përfundim, për këtë pasuri, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se personi i lidhur i subjektit të rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë dhe ka mungesë burimi financiar të ligjshëm për të justifikuar pasurinë sipas nenit 61, pika 3 dhe nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.*

### **III/2. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit lidhur me shkaqet procedurale të ngritura në ankim**

68. *Lidhur me pretendimin se nuk është zhvilluar një proces i rregullt ligjor ndaj subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se Komisioni ka zbatuar me korrektësi në mënyrë të përsëritur kërkesat e subjektit përpara seancës dëgjimore, duke zbatuar kërkesat e nenit 47 të ligjit nr. 84/2016, i cili referon në nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative. Kjo e drejtë gjen pasqyrim më të hollësishëm në pikat 5-12 të vendimit nr. 44, datë 23.07.2018, të Komisionit.*
69. *Lidhur me pretendimin në ankim se Komisioni ka vepruar në kundërshtim me nenin 45, pika 1 e Kodit të Procedurave Administrative, pasi nuk e ka njohur subjektin me materialet e dosjes, trupi gjykues konstaton se më datë 12.07.2018, Komisioni me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Arben Nela në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe, me anë të postës elektronike, subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej më datë 18.07.2018, ora 11:00. Më datë 13.07.2018, subjekti i rivlerësimit kërkoi të njihej me rezultatin përfundimtar të hetimit. Komisioni, pasi rishikoi përgjigjet e rezultateve të hetimit, më datë 17.07.2018, njoftoi subjektin e rivlerësimit se rezultati përfundimtar i hetimit ishte i njëjtë me atë që i ishte dërguar më datë 04.06.2018 me anë të postës elektronike, domethënë nuk ka pasur ndryshim në hetimin administrativ nga Komisioni për subjektin edhe pasi ka administruar prova të ndryshme, të depozituara nga vetë subjekti. Për sa më sipër, subjektit të rivlerësimit nuk i është mohuar e drejta për t'u njohur me aktet e dosjes dhe për të marrë kopje të tyre, si rrjedhojë as e drejta për t'u mbrojtur në mënyrë efektive.*
70. *Për pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni nuk ka marrë vendim të arsyetuar për kërkesën e thirrjes se dëshmitarëve, pavarësisht se nuk ka një vendim të ndërmjetëm të Komisionit,*



*me të drejtë ky i fundit ka vendosur në vendimin përfundimtar rrëzimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit, pasi provat që ka administruar kishin përmbushur plotësisht nevojat e hetimit administrativ, kështu që pyetja e dëshmitarëve ka qenë e panevojshme, pasi Komisioni kishte administruar deklaratat e tyre noteriale.*

71. Për pretendimin se Komisioni nuk ka respektuar procedurën e vlerësimit të provave të paraqitura nga subjekti, sipas nenit 48 të Kodit të Procedurave Administrative, *përgjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj ka rezultuar se Komisioni i ka vlerësuar drejt provat, duke i marrë në harmoni me njëra-tjetrën. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjektit të rivlerësimit i janë dhënë të gjitha të drejtat e parashikuara nga neni 47 i ligjit nr. 84/2016, që parashikojnë zbatimin e dispozitave që përfshijnë nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative, dhe jo të nenit 48 të këtij kodi.*
72. Lidhur me pretendimin e ngritur në ankim se Komisioni nuk ka njoftuar subjektin e rivlerësimit në përputhje me nenin 87 të Kodit të Procedurave Administrative për rezultatet përfundimtare të hetimit, si dhe në kundërshtim me nenin 179/b, pika 2 e Kushtetutës, nenet 45, 55 të ligjit nr. 84/2016, nenet 48, 59, 87, pika 2, germa “ç” e Kodit të Procedurës Administrative nuk ka ftuar subjektin në seancë dëgjimore, *trupi gjykues vlerëson se Komisioni ka zbatuar në mënyrë të rregullt procedurën e thirrjes së seancës dëgjimore, sipas vendimit nr. 3, datë 11.07.2018, duke qenë se ka respektuar paraprakisht edhe dispozitat e mësipërme, pasi me e-mail-in e datës 04.06.2018 ka njoftuar subjektin e rivlerësimit për mundësinë që ka për ushtruar të gjitha drejtat që ai gëzon gjatë procesit të rivlerësimit. Për këtë, atij i është përcjellë edhe materiali përkatës me rezultatet e hetimit dhe njoftimi se, në bazë të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i kalon barra e provës për gjithë sa rezulton nga hetimi. Për sa më sipër, nuk qëndron ky pretendim i ankuesit.*
73. Për sa i përket pretendimit në ankim se, me paraqitjen e provave dhe shpjegimeve të kërkuara nga Komisioni, ezaurohet edhe barra e provës që parashikon ligji dhe më tej barra e provës i kalon Komisionit për të marrë prova të reja, të cilat do të rrëzonin pretendimet e subjektit, *trupi gjykues çmon se ky është një pretendim i pambështetur i subjektit të rivlerësimit. Neni 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 përcakton qartë se: “Nëse Komisioni ose Kolegji i Apelit arrin në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë, sipas nenit 45 të këtij ligji, subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën”. Në kuptim të kësaj dispozite, nuk qëndron ky pretendim i ankuesit.*
74. Mënyra e proceduar nga Komisioni, sipas subjektit, nuk respekton nenin Ç, pika 5, nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 183 të Kodit të Procedurës Civile dhe bashkë me to edhe nenin 41 dhe 179/b, pika 2 e Kushtetutës, si dhe nenin 6 të KEDNj-së, lidhur me parimin e realizimit të një mbrojtjeje efektive. *Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjektit të rivlerësimit i janë dhënë të gjitha të drejtat e parashikuara nga ligji për realizimin e një mbrojtjeje efektive, siç është e drejta për t’u përfaqësuar nga një avokat, e drejta për t’u njohur me dosjen, e drejta për të paraqitur prova dhe për të dhënë shpjegime lidhur me to etj. Me vendimin nr. 2, datë 25.05.2018, trupi gjykues nr. 4 i Komisionit ka vendosur të përfundojë hetimin paraprak, t’i kalojë barrën e provës, si dhe t’i japë subjektit të rivlerësimit të gjitha të drejtat e parashikuara në nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45-47 dhe 35-40 të Kodit të Procedurave*

*Administrative. Në vijim, me e-mail-in e datës 04.06.2018, është njoftuar subjekti i rivlerësimit për sa më sipër, si dhe për të ushtruar të gjitha të drejtat e tij. Me e-mail-in e datës 08.06.2018 subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesën për t'u njohur me aktet, si dhe marrjen e një kopjeje të akteve. Më datë 18.06.2018, Avokat S.N. (vëllai i subjektit) është paraqitur pranë Komisionit me prokurën nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 18.06.2018, për t'u njohur me aktet dhe për të marrë kopje të tyre dhe, në përfundim, ka nënshkruar një deklaratë të datës 18.06.2018, sipas së cilës ai kishte marrë të gjithë dokumentacionin e kërkuar në CD dhe/apo një pjesë të tyre në fotokopje, sipas kërkesës. Pas njohjes së subjektit me rezultatet paraprake të hetimit, atij i është dhënë e drejta që të paraqesë prova dhe shpjegime dhe, më pas, gjatë seancës dëgjimore, subjektit të rivlerësimit i është dhënë mundësia që të dëgjohet lidhur me çdo moment që ai ka gjykuar të arsyeshëm. Trupi gjykues vlerëson gjithashtu se nuk është detyrim i Komisionit që të japë vlerësime paraprake se cilën provë do të marrë parasysh, pasi kjo do të ishte paragjyquese për procesin. Gjithashtu, nuk qëndron pretendimi i subjektit se atij nuk i është vënë në dispozicion relacioni përfundimtar në përputhje me pikat 10 dhe 11 të aktit të Komisionit "Hapat proceduralë", pasi në përputhje me këto pika, relatori i çështjes përgatit relacionin/raportin përfundimtar dhe ia vë në dispozicion trupit gjykues dhe vëzhguesit ndërkombëtar dhe në asnjë rast nuk i vihet në dispozicion subjektit, pasi ky relacion/raport është pjesë e diskutimit për vendimmarrjen e trupit gjykues. Subjekti është njohur me rezultatet e hetimit ashtu siç e parashikon ligji. Debati gjyqësor në seancë dëgjimore ka qenë i hapur, pasi Komisioni e ka njohur subjektin e rivlerësimit në çdo hap procedural me rezultatet e hetimit administrativ. Për sa më sipër, ky pretendim i subjektit nuk pranohet.*

75. *Për pretendimin e subjektit se i është kufizuar e drejta për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore, trupi gjykues vlerëson se Komisioni ka zbatuar në përputhje me nenin 55, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, realizimin e seancës dëgjimore, duke respektuar të drejtën e subjektit të rivlerësimit për t'u dëgjuar brenda një kohe të arsyeshme. Fakti që seanca dëgjimore ka zgjatur afërsisht tri orë, tregon qartë që subjektit të rivlerësimit i është dhënë mundësia për të shpjeguar të gjitha detajet që ai i ka konsideruar të nevojshme, pavarësisht se nga kryesuesja e seancës dhe vëzhguesi ndërkombëtar është orientuar subjekti i rivlerësimit për t'i dhënë shpjegimet në mënyrë të përmbledhur.*
76. *Për pretendimin e subjektit se është gjykuar nga një gjykatë e njëanshme dhe paragjyquese pasi edhe marrja, administrimi, pra hetimi kryesisht në lidhje me pasurinë, çmuarja e provave dhe më pas dhënia e vendimit për subjektin janë bërë nga i njëjti trup gjykues i Komisionit, Kushtetuta dhe ligji kanë përcaktuar qartë rolin dhe organizimin e Komisionit gjatë procesit të rivlerësimit. Anëtarët e Komisionit janë të detyruar të zbatojnë kërkesat që ka përcaktuar ligji, përkatësisht neni 14 i ligjit nr. 84/2016.*
77. *Për pretendimin se Komisioni ka qenë paragjyques, pasi e ka përfunduar procesin e rivlerësimit vetëm për kriterin e pasurisë, trupi gjykues vlerëson se Komisioni ka filluar hetimin administrativ për të tria kriteret e rivlerësimit. Gjatë këtij hetimi, Komisioni pasi ka vlerësuar se e ka hetuar në mënyrë të plotë kriterin e pasurisë, bazuar në provat e grumbulluara dhe provueshmërinë e tyre, ka arritur në përfundimin se vlerësimi i subjektit të rivlerësimit mund të kryhej vetëm për këtë kriter të pasurisë, pa qenë nevoja e përfundimit të hetimit të plotë edhe të dy kriterëve të tjera, kjo parashikuar nga neni 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.*
78. *Lidhur me pretendimin se Komisioni ka shkelur parimin e prezumimit të pafajësisë, në kuptim të nenit 30 të Kushtetutës, si dhe nenit 6.2 të KEDNj-së, trupi gjykues vlerëson se, nëse subjekti i*

*rivlerësimit i është nënshtruar kontrollit të plotë nga ILDKPKI-ja për vitet 2003-2009 dhe ka rezultuar në rregull me deklarinimet e tij, kjo nuk do të thotë që Komisioni duhet ta marrë të mirëqenë këtë kontroll dhe të mos bëjë hetim të mëtejshëm për pasuritë e vëna gjatë këtyre viteve. Në të njëjtën linjë argumentimi është edhe vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese, i cili në interpretim të ligjit nr. 84/2016 mbi pajtueshmërinë e tij me Kushtetutën, shprehet se: “[...] organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”. Gjithashtu, në ligjin nr. 84/2016, konkretisht në nenin 30 e vijues të tij, tregohet qartë procedura që ndiqet për rivlerësimin e pasurisë. Kjo e drejtë ligjore rezulton që është zbatuar nga Komisioni.*

79. Për pretendimin në ankim se subjekti i rivlerësimit është shkarkuar në kundërshtim me nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se, referuar nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon se: “Nëse subjekti i rivlerësimit përpiket të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”, si dhe bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, nisur nga interpretimi sistematik i këtyre dispozitave, nuk është e nevojshme që pamjaftueshmëritë në deklarinimin për kontrollin e pasurisë dhe të figurës të ekzistojnë në mënyrë kumulative, për të konkluduar me vendimmarrjen për shkarkim nga detyra.
80. Në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendoi që mospasqyrimi i likuiditeteve nuk passjell pamjaftueshmëri të burimit të ligjshëm për krijimin e pasurisë dhe që në rast se ka pasaktësi të konstatuara, ato duhet të mbahen parasysht se nuk janë të qëllimshme, nuk mund të konsiderohen si deklarinim i rremë apo fshehje. Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim i ankuesit nuk mund të merret në konsideratë, pasi mospasqyrimi i likuiditeteve, konkretisht kursimeve që “mund” të kishte bërë subjekti i rivlerësimit në deklaratat përkatëse të pasurisë, tregon se subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të bëjë kursime. Pohimi që ai bën në shpjegimet ndaj rezultateve të hetimit pranë Komisionit, si dhe në ankim, se ka pasur mundësi të kursejë nga të ardhurat, por nuk i ka deklaruar në deklarinimet e pasurisë, nuk mund të merret parasysht, si i pambështetur në prova dhe në ligj.
81. Lidhur me pretendimin se Komisioni nuk ka mbajtur të njëjtin standard objektiv vlerësimi në raport me besueshmërinë, pasi në vendimin nr. 51, datë 25.07.2018, vlerëson si të paqëllimtë mungesën e deklarinimit të pasurisë në deklaratën e pasurisë (vetting) 2017, ndërsa për subjektin e rivlerësimit nuk zbaton të njëjtin standard, trupi gjykues vlerëson se standardi i përdorur nga Kolegji është i njëjtë për të gjitha subjektet, ndërkohë që orientimin për Komisionin, Kolegji e bën nëpërmjet vendimeve të dhëna, sipas nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.
82. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi shkaqet e ankimit, parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, provat e administruara në këtë çështje si dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, arrin në përfundimin se:
  - i. Për pasurinë 1, apartament me sipërfaqe 99,4 m<sup>2</sup>, i ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, në pronësi të Arben Nela dhe B.N., subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë kryer deklarinim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, kanë bërë deklarinim të rremë dhe kanë mungesë burimi financiar të ligjshëm për të justifikuar pasurinë, sipas nenit 61, pika 3, dhe nenit 33, pika 5, gjerat “b” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016.

ii. Për pasurinë 2, banesë me sipërfaqe 121,6 m<sup>2</sup> dhe 1/2 e truallit prej 300 m<sup>2</sup>, e ndodhur në Lanabregas, Tiranë, në pronësi të shtetasit Arben Nela, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, ka mungesë burimi financiar të ligjshëm për të justifikuar pasurinë dhe ka kryer fshehje të pasurisë, sipas nenit 61, pika 3 dhe nenit 33, pika 5, germa “b” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016.

iii. Për pasurinë 3, apartament me sipërfaqe 67,6 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, në pronësi të B.N., personi i lidhur i subjektit të rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë dhe ka mungesë burimi financiar të ligjshëm për të justifikuar pasurinë, sipas nenit 61, pika 3 dhe nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

83. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, mbi bazën e parimeve të barazisë para ligjit, kushtetutshmërisë, ligjshmërisë e proporcionalitetit, parime këto që garantojnë të drejtën e subjektit të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor, bazuar në konkluzionet e mësipërme, në mbështetje të nenit D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, çmon se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 44, datë 23.07.2018, është i drejtë dhe duhet lënë në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, mbështetur në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 44, datë 23.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Arben Nela.
2. Ky vendim është përfundimtar, me efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 16.04.2019.

#### **ANËTARE**

**Albana Shtylla**

*nënshkrimi*

#### **ANËTARE**

**Ina Rama**

*nënshkrimi*

#### **ANËTAR**

**Sokol Çomo**

*nënshkrimi*

#### **RELATORE**

**Natasha Mulaj**

*nënshkrimi*

#### **KRYESUESE**

**Rezarta Schuetz**

*nënshkrimi*